



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

---

C.nr.201/2009

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditësit: \_\_\_\_\_ ne Prishtine , te cilin e perfaqeson \_\_\_\_\_ , sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurit : \_\_\_\_\_ nga Mitrovica, Rr., Jeta e Re ,, nr.2/11 , per shkak te borgjit, vlera e lendes se kontestit 165.62 euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt. 15.09.2016, me dt. 26.10.2016 jep kete :

**A K T G J Y K I M**

**OBLIGOHET** i padituri \_\_\_\_\_ nga Mitrovica qe ti paguaj paditesit \_\_\_\_\_ ne Prishtine ne emer te borgjit shumen prej 165.62 euro me kamate 3.5% ne vit qe nga data 23.11.2009, gjere ne pagesen definitive si dhe shpenzimet e procedures kontestimore, ne shume prej 30 euro, te gjitha keto ne afatin prej 15 diteve, nen kerckimin e permbarimit te dhunshem .

**A r s y e t i m**

Paditesi ka parashtru padi kunder te paditurit per shkak te borgjit ne shume prej 165.62 euro, duke theksuar se paditesi me te paditurin kane nenshkruar me dt. 29.01.2009 Kontraten per riprogramimin e borgjit – perkatesisht pagesen e borgjit me keste per shfrytezimin e sherbimeve te telefonise fikse per numrin e telefonit 028-529-342.

Edhe perkunder nenshkrimit te kontrates i padituri nuk i ka permbushur obligimet e veta te pranuar ne kontrate .

Perfaqesuesi i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesor mbeti ne teresi prane padise dhe kerkesepadise duke i propozu gjykates qe te njejten ta aprovoi si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore i kerkoj.

Gjykata seancen e shqyrtimit kryesor e mbajti ne mungese te paditurit , konform nenit 423.4 te LPK-es.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vleresimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: Kontraten per pagimin e borgjit ne keste te dt.26.01.2009 dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga kontrata e siperecekur konstatohet se : i padituri ka pranuar kushtet e pergjitheshme te kontrates ku e njehti ka marr per obligim qe borgjin e siperecekur ta paguaj me keste mujore duke filluar nga dt. 01.01.2009 e gjere me dt. 01.10.2009.

Nga deklarata e te autorizuarit te paditesit rrjedhe se e padituri nuk e ka permbushur obligimin e saj sipas kontrates se siperecekur .

Konform nenit 17 al 1 te Ligjit mbi Marrdhenjet Detyrimore ( vjeter ) , i aplikuar ne rastin konkret , konform nenit 1057 te Ligjit per Marrdhenjet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077) eshte percaktuar se : palet ne marrdhenje detyrimore jane te obliguar ti permbushin detyrimet e tyre dhe jane pergjegjes per permbushjen e te njejtave.

Duke bere interpretimin e kesaj dispozite ligjore rrjedhe se : ne rastin konkret palet kane lidhur kontraten e siperecekur dhe me vullnetin e tyre te lire kane pranuar kushtet e pergjitheshme te kontrates, mirepo i padituri nuk i ka permbushur obligimet e veta te pranuar me kete kontrate, prandaj gjykata te njejten e obligoi si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Vendimi mbi kamaten bazohet ne dispoziten e nenit 277 te LMD-es, te siperecekur duke filluar qe nga data e ngritjes se padise ne gjykate e gjere ne pagesen definitive.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore bazohet ne dispoziten e nenit 10.1 te Udhezimit Administrativ nr.2008/02 per unifikimin e taksave gjyqesore duke i njohur paditesit shpenzimet ne emer te taksave gjyqesore per padi dhe vendim , shumen prej 30 euro.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**  
C nr.201/2009 dt.26.10.2016.

Gjyqtari,  
Ragip Kadriu,

**KESHILLE JURIDIKE;** Kunder ketije aktgjykimi lejohet ankesa ne afatin prej 15 diteve , nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit te Kosoves e permes kesaj gjykate.